



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-03/22

Datë: 28. 06. 2022, ora 15⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 28 Qershor, 2022, në orën 15⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Besart Tofaj-Nënkryetar i Komunës - Koordinator i KKSB-së,
2. Rasim Sylaj- Komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Imer Krasniqi-Përfaqësues i Bashkësisë Islame,
4. Zejnepe Gaxherri-Kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhevahire Krasniqi-Zyrtare për Barazi Gjinore,
6. Xhavit Velijaj-Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
7. Xhavit Gaxherri-Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
8. Arbër Gjota- Përfaqësues i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi,
9. Shkëlzen Shehu- Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
10. Dukagjin Llojuni -Përfaqësues nga OJQ,
11. Leonita Jasiqi - Përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
12. Afërdita Shehu - Kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
13. Qamil Jasiqi-Përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe
14. Berat Babaj- Përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi - Përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Arsim Shehu -Përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, dhe Dervish Avni Muslijaj- “Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik.

Në këtë mbledhje morën pjesë edhe; Drejtoresha për Administratë Publike znjsh. Leonora Shehu dhe Zeqë Hebibi-Zyrtar Administrativ.

Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, e shpalli të hapur koordinatori i KKSBB-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, dhe nga anëtarët Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Raporti mbi gjendjen e kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut, dhe
4. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje të KKSBB-së.

Pika e parë të Rendit të Ditës,
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Koordinatori i KKSBB-së z. Besart Tofaj nga anëtarët e këtij Këshilli kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e kësaj pike, e cila me 13 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua.

Fjalën e kërkoj rreshteri z. Berat Babaj, përfaqësues i FSK-së në KKSBB në Junik, i cili tha, ne kemi zonën e përgjegjësisë që fillon nga Istogu deri në Dragash, pra komplet Zonën e Dukagjinit. Sot unë e zëvendësoj përfaqësuesin tonë z. Albestrim Rexhepin. Për shkak të angazhimeve tona nuk kemi mundur të marrim pjesë në dy takimet paraprake të KKSBB-së, mirëpo kemi përcjellë zhvillimet përmes rrjeteve sociale dhe procedurave administrative.

Pika e dytë të Rendit të Ditës,
Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut

Për këtë pikë fjalën e mori Komandanti i Policisë në Junik z. Rasim Sylja i cili tha, situata e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë. Aktivitetet policore vazhdojnë çdo ditë për parandalimin e dukurive negative. Tani veç kemi hyrë në sezonin veror, dhe do të kemi fluks të madh të bashkatdhetarëve. Do të ketë edhe qarkullim më të dendur të automjeteve në rrugë. Tani do të fillojnë edhe ahengjet e ndryshme, por Policia e Kosovës në Junik veçse ka bërë planifikimet e duhura për këtë sezon, siç është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, dhe rregullimi i komunikacionit rrugor. Ne do të kemi tolerance ndaj bashkatdhetarëve, në mënyrë që ata t'i kalojnë pushimet sa më mirë. Ne, edhe tani si çdoherë do të bashkëpunojmë me pronarët e hoteleve, sidomos sallat e dasmave, dhe do t'i marrim listat e gjithë atyre njerëzve të cilët paraprakisht kanë caktuar terminet e dasmave. Kjo për qëllim të ruajtjes së rendit publik, për mbajtjen e situatës nën kontroll dhe parandalimin e rreziqeve të ndryshme.

Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet bjeshkës, parandalimit së vjedhjes së pyjeve, dhe degradimit të Parkut Nacional. Në bashkëpunim me Policinë Kufitare do të patrullojmë zonën e bjeshkës. Kemi pasur një rast të zjarr-vënies, ndërsa unë falënderoj zjarrfikësit për punën e jashtëzakonshme, si në këtë rast dhe të gjitha rastet ku kërkohej intervenime të tilla. Pra, këto janë disa shqetësime të cilat mund të na shfaqen, siç janë zjarret dhe zjarr-vëniet.

Pra, këtu duhet të kontribuojmë të gjithë së bashku, dhe jemi në bashkëpunim edhe me KLSP-në lidhur me sigurinë e përgjithshme.

Çështje tjetër përpos zënies së trotuareve nga veturat, tani kemi edhe zënien e trotuareve me tavolina dhe karriga nga pronarët e lokaleve, dhe nëse kërkohet ne do të bashkëpunojmë edhe me inspektorët komunal, dhe po ashtu do të kërkojmë respektimin e orarit të punës në lëminë e gastronomisë. Unë e di se ata që vazhdojnë me dasma pas orës 12:00 të natës duhet të kenë leje të posaçme nga Komuna e Junikut.

Koordinatori z. Besart Tofaj pyeti për rastin e arrestimit të një qytetari në Qendër në Junik?

Z. Rasim Sylja tha, po kjo ka ndodhur, që një qytetar ka qenë i dehur dhe ka thyer një xhamë të marketi Ardi-J, në Qendër. Ku si pasojë ai ka lënduar dorën, dhe të cilin qytetar e kemi dërguar për trajtim në QKMF-në e Junikut.

Ndërkohë, derisa ne kemi pritur ndihmën e ambulancës për dërgimin e personit të dehur për trajtim në QKMF, ka ardhur një qytetar tjetër i cili na ka akuzuar neve për shkak të atij lëndimi, të cilit i treguam se qytetari ishte vetëlënduar, dhe të cilit ia kemi tërhequr vërejtjen që të largohet nga aty. Mirëpo ai kishte vazhduar me akuzat, dhe me pas na është dashtë ta arrestojmë dhe t'i hapim rast.

Z. Besart Tofaj po ashtu pyeti Komandantin e Policisë z. Rasim Sylja, nëse kishte pasur alarme të rrejshme në Junik.

Z. Rasimi Sylja tha, nuk ka pasur ndonjë rast të tillë në Junik.

Rreshteri i FSK-së z. Berat Babaj tha, si informatë desha të iu tregoj se të gjitha angazhimet që i ka Regjimenti i Dytë që gjendet në Istog i koordinon për juve në Komunë, kur është rasti për ndonjë lëvizje apo marshim, në mënyrë që të mos shqetësohen qytetarët, ose të mos ketë ndonjë befasi për qytetarët. Kështu që për informim të qytetarëve ne e praktikojmë që informatat të merren tek zyrtarët komunal, në bashkëpunim me Stacionin e Policisë.

Pika e Tretë Rendit të Ditës, *Raporti mbi gjendjen e kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut*

Drejtoresha e Administratës së Përgjithshme znjsh. Leonora Shehu tha, sipas raportit të zyrtarit të IT-së në Komunën e Junikut, kamerat e sigurisë nuk janë në funksion që nga data 20 Gusht 2020, dhe të njëjtën ditë është bërë njoftimi, ku thuhet se për shkak të motit me vetëtimë dhe bubullimë ka pasur ndërprerje të funksionimit të këtyre kamerave. Pastaj, një njoftim tjetër për gjendjen kamerave të sigurisë është bërë me datë, 30 Tetor 2020, dhe nga inspektimi në terren konstatohet se siguresa ka qenë e ndërprerë, ndërsa moduli i fibrës është djegur, dhe për shkak të shpëputjes së kabllos dhe daljes jashtë të fijeve, janë detyruar që t'i shpëputin nga energjia elektrike për shkak të sigurisë së përgjithshme.

Pra, kamerat janë jashtë funksionit por së shpejti pritet shpallja e tenderit për funksionimin dhe mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut.

Z. Imer Krasniqi kërkoj që sipas mundësisë të shtohen kamera të sigurisë të Xhamia, në lagjen Qok.

Z. Xhavit Gaxherri pyeti nëse zyrtari i IT-së ka vendim dhe trajnim të duhur për menaxhimin e kamerave të sigurisë publike?

Znjsh. Leonora Shehu tha, zyrtari i IT-së është marrë me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre, pasi që nuk ka pasur një kontratë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Z. Xhavit Gaxherri tha zyrtari punon vetëm deri në orën 16.00 dhe pastaj kush i kontrollon kamerat? Unë kisha dal me një propozim që kurdo që të rregullohen kamerat të kalojnë në monitorim të policisë, meqë polica është një institucion që na jap 24 orë siguri. Pra, kjo do të ishte më logjike dhe më ligjore, sepse jo çdokush mund të ketë qasje në të dhënat tona personale për shfrytëzim dhe shumëzim të materialit.

Z. Qamil Jasiqi pyeti se sa kamera të sigurisë janë të parapara për tu vendosur në Komunën e Junikut?

Z. Besart Tofaj tha, nuk e kemi paramasën e saktë se sa kamera do të vendosen, kjo është çështje e brendshme derisa të del në prokurim.

Z. Rasim Sylja tha, të gjitha kamerat e sigurisë publike nëpër komunitet e Kosovës vëzhgohen nga policia, dhe kjo ka ndikim në parandalimin e krimit.

Xhavit Gaxherri tha, është mirë që institucioni, në këtë rast Komuna, kur të jepet tenderi apo të vendosen kamerat, të konsultohet Agjensioni për Informacion dhe Privatësi që mbikëqyrë zbatueshmërinë e ligjit mbi të dhënat personale. Besoj dhe rekomandoj që menaxhimi i kamerave të sigurisë publike të kalojë në sektorin e sigurisë në Polici.

Z. Shkëlzen Shehu tha, këto kamera kryesisht kanë qenë të vendosura në Qendër dhe në rrugët apo vend-deponitë e mbeturinave.

Pika e Katërt e Rendit të Ditës, *Të ndryshme*

Z. Imer Krasniqi kërkoj që të bëhet kontrollimi i funksionalizimit të hidrantëve në Komunën e Junikut.

Z. Shkëlzen Shehu tha, hidrantët janë në lagjet; Krasniq, Gaxherr, Berishë, Gacafer, Pepsh dhe Bajraktar. Për legalizimin e tyre D.SH.P. para disa muajve ka legalizuar vetëm tre hidrantë, një të Xhamia në qendër të Junikut, një në Berishë dhe një te pompa e benzinës në lagjen Qok. Këto duhet legalizuar dhe kërkesën e kanë bërë te Hidrodrini, mirëpo ata nuk kanë sjellë shkresë as në Drejtori as tek unë, që hidranti është jashtë funksionit. Hidrodrini nuk e merr përgjegjësinë për ndreqjen e tyre, por thonë se ndreqja e tyre është përgjegjësi e Shërbimeve Publike.

Neve zjarrfikëseve ata duhet të na i sjellin hartën dhe të tregojnë se cilët hidrantë janë funksional dhe cilët jo. Zjarrfikësit nuk mund t'i riparojnë hidrantët. Unë lidhur me këtë kam bërë kërkesë zyrtare të Hidrodrini dhe të Drejtoria për Shërbime Publike, se cilët hidrantë janë funksional, apo të bëhet legalizimi i të gjithë hidrantëve. Pra, hidrantët janë funksional të shkolla fillore dhe e mesme, të ambulanta dhe dy të zjarrfikësit, por mbetet që të legalizohen edhe në lagjet tjera.

Z. Arber Gjota tha, do të ishte mirë që të kishte një plan që të dilet në terren dhe të dihet se cilët hidrantë janë dhe cilët nuk janë funksional, si dhe kërkojmë më shumë gatishmëri dhe intervenim më të shpejtë nga komandanti i Njesisë së Zjarrfikësve.

Z. Shkëlzen Shehu tha, siç e dini edhe ju, ne kemi mungesë të stafit të zjarrfikësve, mirëpo ne bëjmë më të mirën brenda mundësive tona.

Z. Xhavit Velijaj pyeti se kush është përgjegjës për kontrollimin e hidrantëve, jo vetëm nëpër lagje por dhe nëpër institucionet publike, dhe sa është funksional hidranti brenda objektit të Komunës?

Z. Shkëlzen Shehu tha, hidranti në Komunë nuk është funksional fare, sepse nuk është i lidhur. Për këtë duhet pyetur ai që ka bërë objektin, ndërsa për këtë është i informuar edhe Kryetari.

Z. Xhavit Velijaj tha, këto çështje duhet të adresohen, duhet të ketë një rregullore për testimin e hidrantëve, sikurse që janë bombolat për shuarjen e zjarrit, sepse edhe ato testohen me afat.

Z. Shkëlzen Shehu tha, për objektin e Komunës kemi bërë Planin Emergjent, dhe këtë ia kemi dorëzuar Kryetarit. Është cekë që hidranti nuk është i lidhur në ujë, d.m.th., nuk ka hidrantë funksional në këtë objekt.

Ato që janë të legalizuara janë funksional, siç janë shkollat të cilat kanë edhe Planin Emergjent. Këto janë lëshime nga komisionet e pranimi teknik të objekteve.

Z. Xhavit Gaxherri tha, unë desha të përgëzoj për intervenimin e shpejtë të Njësitit të Zjarrfikësve dhe qytetarëve në rastin e zjarrit në lagjen Gaxherr, dhe kërkoj që ushqimi i kafshëve mos të grumbullohet afër shtëpive të banimit dhe objekteve përcjellëse të shtëpive, në mënyrë që të evitohet rreziku nga zjarri, si për shtëpitë ashtu edhe për banorët.

Z. Besart Tofaj tha, ky propozim do të merret parasysh, ndërsa edhe ne si KKSB mund të dalim me një thirrje të tillë.

Z. Xhavit Gaxherri tha, unë si përfaqësues i Këshillit të Prindërve për shkollat në Junik, propozoj që të bëhet Plan Emergjent për evakuimin e nxënësve në rast të ndonjë rreziku. Tjetër, kërkoj që sipas udhëzimit Administrativ, neni 6 thotë së KKSB fton Ministrinë e Punëve të Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike që të merr pjesë në takimet e KKSB-së.

Z. Arbër Gjota tha, në mbledhjen e kaluar kemi bërë një projekt-propozim për fushatën e sigurisë, të cilit ia kemi shtuar edhe kujdesin nga zjarret, në mënyrë që sadopak të ndihmojmë edhe në këtë drejtim. Kemi bërë edhe një fletushkë ku përshihen të gjitha pikat, për të cilën kemi kërkuar përkrahjen e Komunës dhe Policisë, në mënyrë që ky projekt të finalizohet. Ky projekt do të zbatohet kah mesi i Korrikut dhe fillimi i Gushtit, sepse atëherë do të kemi fluksin më të madh të mërgimtarëve në komunën tonë.

Këtu kemi cekë edhe buxhetin e këtij projekti. Janë paraparë 1000 kopje të kësaj broshure, dhe kemi paraparë edhe 50 posterë të formatit A-3 për bizneset. Disa nga këta posterë do të vendosen edhe në rrugën për bjeshkë, si dhe janë bërë 7 bluza për 7 anëtarët e KLSP-së. Pra, këto janë të përfshirë në këtë projekt.

Stacioni i Policisë në Junik ka shprehur gatishmërinë që të na ndihmoj në këtë projekt, nëse nuk do të ndihmoheni nga Komuna.


Z. Besart Tofaj tha, ne në mbledhjen e fundit kemi shprehur gatishmërinë për ndihmë, ne do ta shqyrtojmë mundësinë për ndihmë dhe përkrahje të këtij projekti.

Z. Xhavit Gaxherri tha, unë si anëtar i KKSB-së jam në mbështetje të këtij projekti, përkatësisht kësaj fushate, e cila mendoj se është e qëlluar!


Z. Arbër Gjota tha, ne si KLSP, në bashkëpunim me Policinë kemi edhe projekte tjera për sigurinë në komunën tonë, dhe kemi identifikuar donatorë për përkrahjen e këtyre projekteve të KLSP-së, të cilat do t'i finalizojmë shumë shpejtë.

Me kaq, koordinatori z. Besart Tofaj shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSB-së.

Procesmbajtësi,


Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së


Ruzhdi Shehu